



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1384/2 Prot.

Vlorë më 13.05.2026

VENDIM

Nr. 28, datë 13.05.2026

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË INTEGRUAR TË CIKLIT TË DYTË
MASTER I SHKENCAVE NË "DREJTËSI", NË FAKULTETIN E SHKENCAVE
HUMANE, NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE**


Në mbështetje të nenit 25, pika 7, nenit 38, pika 1, shkronja "dh", dhe nenit 75 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenit 10, pika 6, dhe nenit 19, pika 1, shkronja "ë", të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; Udhëzimit nr. 1 të MAS, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve"; VKM-së nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuar; si dhe referuar propozimit të Departamentit të Drejtësisë dhe propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmëse Akademike, përcjellë me shkresën nr. 1237/1 prot., datë 12.05.2026, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 13.05.2026,

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Drejtësisë në Fakultetin e Shkencave Humane për riorganizimin e programit të studimit "Master i Shkencave në Drejtësi", si më poshtë:

1. Ndryshime në kredite dhe ristrukturim i lëndëve:

- "E drejtë kushtetuese" nga 10 kredite bëhet 12 kredite dhe ristrukturohet në dy module:
 - "E drejtë kushtetuese I (Pjesa e përgjithshme)" – 6 kredite
 - "E drejtë kushtetuese II (Pjesa e posaçme)" – 6 kredite
- "Hyrije në ekonomi" nga 6 kredite bëhet 4 kredite
- "Teknologji informacioni" nga 6 kredite bëhet 4 kredite
- "Filozofi e së drejtës" nga 6 kredite bëhet 8 kredite
- "E drejtë e mjedisit" nga 6 kredite bëhet 8 kredite
- "Kriminalistikë" nga 8 kredite bëhet 6 kredite



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- "Praktikë/Klinikë e ligjit" nga 12 kredite bëhet 14 kredite
- "Diplomë/Provim përfundimtar" nga 14 kredite bëhet 12 kredite

Totali i krediteve të ndryshuara: 16 kredite, që përbën 5.33% të programit total (300 kredite), brenda kufirit të lejuar deri në 20%.

2. Ndryshime organizative në shpërndarjen e lëndëve sipas viteve akademike:

- Lënda "Procedurë civile" do të zhvillohet në vitin e katërt
- Lënda "E drejtë e Bashkimit Evropian" do të zhvillohet në vitin e tretë

Këto ndryshime bazohen në logjikën progresive të ndërtimit të njohurive dhe synojnë përmirësimin e organizimit akademik të programit.

3. Rishpërndarja sipas kategorive të veprimtarive formuese (në përputhje me Shtojcën nr. 1 të VKM nr. 41, datë 24.01.2018):

- Kategoria A – Disiplina bazë: 20% nuk ka ndryshime
 - Kategoria B – Disiplina karakterizuese: ka qenë 52.7 ka kaluar 53.33%
 - Kategoria C – Disiplina ndërdisiplinore: 14.7% nuk ka ndryshime
 - Kategoria D – Veprimtari praktike dhe profesionale: 8% nuk ka ndryshime
 - Kategoria E – Diplomë/Provim përfundimtar: ka qenë 4.6 dhe ka kaluar 4% .
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektori Akademik, drejtuesit e Fakultetit të Shkencave Humane, si dhe Drejtorja e Shërbimeve Ndihmëse Akademike.
 3. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet për dijeni Ministrisë së Arsimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj

